


REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO




Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority







RAPORT VJETOR
I AUTORITETIT KOMBËTAR TË KUALIFIKIMEVE
2013




AUTORITETI KOMBËTAR I KUALIFIKIMEVE / NACIONALNI AUTORITET ZA KVALIFIKACIJE / NATIONAL QUALIFICATION AUTHORITY / 2014


REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority








PËRMBAJTJA

Hyrje 12
Kush jemi ne 12
Synimet dhe objektivat tona 13
Akterët relevant të 14
Konteksti ynë 15
Si planifikojmë ne 16
Raporti Vjetor për 2013-ten 20
Aktivitetet e realizuara 21
Standardet e Profesionit 22
Rregullimi i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve 23
Validimi i kualifikimeve në KKK dhe akreditimi i ofruesve të AAP 26
- Vizita në terren 27
- Përpilimi i raportit final të vlerësimit për Validim dhe Akreditim 28

Promovimi i KKK dhe AKK 34
Zhvillimi dhe rishikimi i ueb-faqes 48
Bashkëpunimi ndërkombëtar 49

LISTA E SHKURTESAVE

AAP	Arsimi dhe Aftësimi Profesional
AKA	Agjencia e Kosovës për Akreditim për Arsimin e Lartë
AKK	Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
ETF	Fondacioni Evropian për Trajnime
IPA	Instrumenti i Ndihmës për Para-Anëtarësim (i UE-së)
KAAP	Këshilli për Arsim dhe Aftësim Profesional
KE	Komisioni Evropian
KEK	Korniza Evropiane për Kualifikime
KKK	Kombëtare e Kualifikimeve
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës & Teknologjisë
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
SC	Sigurimi i Cilësisë
UE	Unioni Evropian
ZNKE	Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian



Ragip GJOSHI, *Kryetar i KD të AKK*

Po vazhdon të popullohet Korniza…

Arsimi dhe Aftësimi Profesional në Republikën e Kosovës, është në rrugë të mbarë të merr më në fund rëndësinë që i takon në politika, në arsim dhe në tregun e punës. Në reformën e arsimit dhe aftësimit profesional, Kosova po ecën përpara, por në të njëjtën kohë po has edhe sfida të mëdha. Në gjithë spektrin e institucioneve që kanë fushëveprimi arsimin profesional,ndjeshëm shquhet dhe mund të veçohet aktiviteti i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve si një agjenci me kompetencë për realizimin e misionit dhe objektivave të kornizuara me ligjin e miratuar vite më parë. Këshilli Drejtues bashkë me stafin e Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK) ka vepruar sistematikisht në zhvillimin e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve dhe për të rregulluar sistemin kombëtar të kualifikimeve dhe për të harmonizuar atë me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve (KEK), duke mundësuar ndërlidhjen dhe komunikimin në mes të kornizave të ndryshme kombëtare. Angazhim tjetër me prioritet i AAK-së ishte edhe përkushtimi për jetësimin e "Mësimit gjatë gjithë jetës" që me një Udhëzim administrativ është përcaktuar dhe rregulluar përfshirja e të gjitha aktiviteteve të mësimit, që realizohen gjatë tërë jetës për zhvillimin e njohurive, kompetencave dhe kualifikimeve. Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve suksesshëm ka bashkëpunuar edhe gjatë këtij viti me të gjithë partnerët social, me organizatat që përfaqësojnë në mënyrë kolektive punëdhënësit dhe punëtorët. Gjatë vitit 2013 në takimet e Këshillit Drejtues të AKK është

realizuar Plani i Punës dhe synimet kryesore të AKK-së. Në këtë periudhë vlenë të veçohen aktivitete, si: popullimi i KKK me aprovimin e kualifikimeve pas procesit të validimit; akreditimin e ofrueseve publik dhe privat të arsimit dhe aftësimit profesional në të gjithë vendin; promovimi i KKK me organizimin e aktiviteteve që krijon vetëdijesim të audiencës së përgjithshme dhe të synuar për fushëveprimin e AKK-së; pjesëmarrje të gjerë në projektet e BE-së dhe aktivitete ndërkombëtare, si pjesë e zhvillimit të vazhdueshëm profesional të AKK-së. Ndër çështjet që ishin preokupim i vazhdueshëm edhe i KD të AAK-së ishte edhe sigurimi i cilësisë, që nënkupton procesin përmes të cilit mirëmbahet cilësia dhe pajtueshmëria e standardeve të kualifikimit, vlerësimit dhe certifikimit. Validimi i standardeve të profesionit, ishte detyrë e rëndësishme vjetore e KD, sepse kështu u vërtetua se standardet janë tregues të matshëm i të arriturave, që caktohen sipas kritereve kualitative ose kuantitative dhe duhet të arrihen nga kandidatët, që duan të kualifikohen. Në mbështetje të zbatimit të regulativave të Ligjit të KK është bërë punë e mirë në zhvillimin dhe mbarëvajtjen e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve. Procesi i akreditimit ishte një sferë tjetër e rëndësishme dhe KD ka përcaktuar institucionet që plotësojnë kriteret për të vlerësuar kandidatët dhe institucionet qe mund të lëshojnë certifikata dhe diploma dhe ka akredituar ato. AAK ka krijuar sistemin për akumulimin dhe transferin e kredive, ka ndikuar në rritjen e cilësisë dhe rëndësisë së arsimit dhe aftësimit, duke nxitur zhvillimin e kualifikimeve në bazë të standardeve të njohurive, shkathtësive dhe kompetencave të krahasueshme me nivelin ndërkombëtar dhe të të mbështetura në sigurimin e cilësisë. Qeveria Kosovës synon rritjen e pjesëmarrjes në arsimin dhe aftësimit profesional, ndërlidhjen me nevojat e tregut të punës, me qëllim rritjen e aftësisë për punësim të të rinjve e të rriturve si dhe përmirësimin e fuqisë punëtore në vend. Këto objektiva kërkojnë mbi të gjitha fleksibilitet dhe shumëllojshmëri të kurseve, gjë që nga ana tjetër nxit bashkëpunimin e të gjithë grupeve të interesit në të gjitha frontet, që nga hartimi i politikave, financimi i arsimit dhe aftësimit profesional, administrimi dhe ofrimi i arsimit dhe formimit dhe për rrjedhojë decentralizimi në vendimmarrje. AAK ka shprehur gatishmërinë për të modernizuar shkollat e arsimit profesional dhe kapërcimin e "mureve ndarëse" në mes ministrive dhe që pengojnë sistemin e arsimit dhe aftësimit profesional. Përgjatë këtij viti u arritën disa rezultate të prekshme, që shkonin përtej pritjeve, u ofruan zgjidhje praktike dhe u propozuan rrugë të reja për zbatimin e politikave në fushën e arsimit dhe arsimit profesional. Në fund në emër të KD të AKK-së, gjithë pjesëmarrësit në sistemin e AAP dhe ARR, uroj për suksese të reja qe Kosovës ta kemi në nivelin e shteteve të BE-së!



Teuta Danuza *Drejtore e AKK*

Zbatimi i KKK-së!

Gjatë 2013, Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK) ka vazhduar drejt realizimit të misioni të saj për të ndihmuar të gjithë ofruesit e trajnimit dhe nxënësit për të lëvizur drejt niveleve të përsosmërisë në arsim dhe trajnim, për të rritur cilësinë në Arsimin dhe Aftësimin Profesional, për të ju mundësuar nxënësve që të pajisen me shkathësitë e duhura për tregun e punës dhe më e rëndësishmja për të bërë të mësuarit gjatë gjithë jetës një mjet për të mbështetur punësimin e tyre.

Qasja pragmatike e zbatimit të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK) është çelësi i suksesit të AKK-së në vitin 2013, duke vazhduar me procesin e verifikimit të standardeve të profesionit, miratimin e kualifikimeve në nivelet 2,3 dhe 4 në KKK, si dhe akreditimin e institucioneve që vlerësojnë dhe lëshojnë këto kualifikime. Cilësia e këtyre kualifikime është në përputhje me standardet evropiane dhe këto kualifikime përmbushin nevojat e tregut të punës dhe shoqërisë në Kosovë.

AKK gjatë 2013 gjithashtu ka vazhduar me ngritjen e kapaciteteve për sigurim te cilësisë në shkollat profesionale të MASHT-it dhe me të gjithë ofruesit e akredituar duke organizuar takime individuale, punëtori dhe seminare. Me qëllim të përmirësimit të mobilitetit të


fuqësië punëtore në vendet e Bashkimit Evropian, AKK ka inciuar procesin e referencimit të KKK ndaj Kornizës Evropiane të Kualifikimve. Ky proces ka për qëllim që të shërbejë si mjët përkthimi dhe krahasimi i kualifimeve që ofrohen dhe lëshohen në Kosovë me kualifikimeve e vendeve të BE-së e që do të ju mundësojë qytetarëve tanë punësueshmëri edhe në këto vende.

Poashtu, ne kemi vazhduar të marrin plotësisht parasysh pikëpamjet e partnerëve tanë dhe palëve të interesit duke realizuar dy hulumtime; njërin rreth ndikimit të procesit te validimit të kualifikimeve dhe akreditimit nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve dhe tjetrin rreth ndikimit të zbatimit të Kornizës për Sigurim të Cilësisë në Shkollat profesionale dhe tek të gjithë ofruesit tjerë të AAP-së. Hapja e një faqe zyrtare në rrjetin social "facebook", realizimi i dy reklamave televizive si dhe takime individuale me ofruesit për komentimin e raportit të vetë-vlerësimit janë disa nga veprimet konkrete qe AKK i ka ndërmarr bazuar në rezultatet e dala nga këto hulumtime.

AKK ka qene mjaft aktive në ngjarjet vendore, rajonale dhe evropiane në fushën e kualifikimeve dhe sigurimit të cilësisë. AKK gjatë vitit 2013, ka marr pjesë në të gjithat takimet e Rrjetit Evropian për Sigurim të Cilësisë në AAP – EQAVET. Poashtu ka marr pjesë në disa seminare dhe forumin e Sistemit Evropian të Kredive për Arsim dhe Aftësim Profesional – ECVET dhe ka pulbikuar një artikull në revisten e rrjetit Evropian-EVCET për zbatimin e iniciativave Evropiane ne sistemin arsimor te AAP ne Kosove. Pjesëmarrja në këto rrjete Evropiane është hap para drejt realizimit të synimeve të AKK-së; ngritjen e cilësisë në arsimin dhe trajnimin në Kosovë në përputhje me standardet evropiane.

Për këto arritje, ne i jemi shumë mirënjohës Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Fondacionit Evropian për Trajnim dhe Këshillit Britanik për angazhimin dhe zotimin e vazhdueshëm për të përkrahë AKK-në drejt përmbushjes së misionit të saj që; të zhvillojë veten si një institucion me një drejtim, atë të ngriitjes së cilësisë në arsimin dhe trajnimin në Kosovë, gjithnjë duke u bazuar në filozofinë e të mësuarit gjatë gjithë jetës.

Unë do të doja të zgjeroj këtë falënderim për të gjithë partnerët dhe donatorët e tjerë që mbështesin punën e AKK!
Një falënderim i veçantë vlen edhe për ministrin e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ramë Buja, për mbështetjen e iniciativave tona dhe zotimin për përkrahje të mëtejme të AKK-së dhe KKK-së. Gjithashtu, do të falënderoja Këshillin Drejtues dhe stafin ekzekutiv të AKK-së për kontributin madhor në zhvillimin e institucionit, si dhe performancën gjatë vitit 2012-13!



AUTORITETI KOMBËTAR I KUALIFIKIMEVE / NACIONALNI AUTORITET ZA KVALIFIKACIJE / NATIONAL QUALIFICATION AUTHORITY / 2014

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve

Këshilli Drejtues:

RagipGjoshi	Kryetar i Këshillit Drejtues të AKK-së (MASHT)
Anton Gojani	Nënkryetar i Këshillit Drejtues te AKK-se (DonBosko)
Agim Shahini	Anëtar -Aleanca Kosovare e Biznesit
Arbëresha Turjaka	Anëtare- Ministria e Shëndetësisë
Florent Bakija	Anëtar -Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Bedri Xhafa	Anëtar – Agjencia e Përkrahjes së Punësimit në Kosovë
Besim Mustafa	Anëtar- Oda Ekonomike
Edita Krasniqi	Anëtare -Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Ferdije Zhushi	Anëtare - Agjencia e Akreditimit të Kosovës
Visar Jasiqi	Anëtar- Universiteti Amerikan i Kosovës
Mehreme Llumnica	Anëtare -Handikos
Menderes Ibra	Anëtar -Ministria e Ekonomisë dhe Financave
Tahir Arbneshi	Anëtar -Universiteti i Prishtinës

Stafi ekzekutiv:

Teuta Danuza	Drejtoreshë
AvniGashi	Ekspert për sigurim të cilësisë
Bleta Kadriu	Eksperte për standarde
Milot Hasangjekaj	Ekspert për kualifikime
KaltrinaMulliqi	Eksperte për sigurim të cilësisë
Donjeta Nimani	Asistente Administrative



Ligji për Kualifikime Kombëtare

Kush jemi ne

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK) është organ i pavarur publik, i themeluar në dhjetor të vitit 2009, bazuar në Ligjin për Kualifikimet Kombëtare (Ligji 03/L-060).

AKK-ja ka përgjegjësi të përgjithshme për Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK); në përcaktimin e niveleve të kualifikimeve në KKK, harmonizimin e niveleve të kualifikimeve me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve (KEK), caktimin e kritereve për aprovimin e kualifikimeve dhe akreditimin e institucioneve të arsimit dhe aftësimit profesional(AAP), përfshirjen e kualifikimeve të aprovuara në KKK, lehtësimin e progresit dhe transferit ndërmjet formave të ndryshme të të mësuarit, dhe sigurimin e cilësisë në institucionet e akredituara të AAP-së.

AKK-ja ka Këshillin Drejtues prej trembëdhjetë (13) anëtarësh, të aprovuar nga Qeveria e Kosovës, i cili është i përfaqësuar nga ministritë, organizatat e partnerëve social dhe universitetet publike.

AKK-ja ka stafin ekzekutiv prej gjashtë (6) anëtarëve: të drejtores, zyrtares për standarde, zyrtarit për kualifikimeve, dy zyrtarëve të sigurim të cilësisë dhe asistentes administrative.

Synimet dhe objektivat tona

"Misioni i AKK-së është të mbikëqyrë dhe zhvillojë Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve në kontekst të të mësuarit gjatë gjithë jetës, në partneritet me nxënësin/kandidatin, punëdhënësin dhe ofruesit e arsimit dhe aftësimit në gjitha nivelet dhe në përputhshmëri me nevojat dhe kërkesat e shoqërisë dhe ekonomisë.
Vizioni i AKK-së është krijimi i një sistemi cilësor, të besueshëm dhe transparent të kualifikimeve kombëtare, me qëllim të rritjes së mundësive për mobilitet kombëtar dhe ndërkombëtar."

Për të arritur këtë, AKK-ja do të:

- aprovoj kualifikime që do të përfshihen në nivelet e caktuara të kornizës dhe të riaprovoj ato sipas nevojës;
- akreditojë, rregullojë dhe monitorojë ofruesit e arsimit dhe aftësimit profesional;
- zbatojë sigurimin e jashtëm të cilësisë së vlerësimeve, që çojnë deri tek dhënia e kualifikimeve në KKK;
- mirëmbajë bazën e të dhënave dhe evidencave të verifikuara dokumentuese të kualifikimeve në KKK dhe të certifikatave dhe diplomave të dhëna;
- bëjë rishikime periodike të vlerësimit, si dhe krahasime ndërkombëtare të kualifikimeve;
- këshillimin e institucioneve përgjegjëse për njohjen e kualifikimeve të huaja, për qëllime akademike ose punësimi, mbi çështjet e krahasueshmërisë dhe barasvlerës;
- certifikatat dhe diplomat e dhëna për të gjitha kualifikimet në kornizë miratohen me vulë të autoritetit dhe përfshijnë titullin e aprovuar të kualifikimit, nivelin e tij në KKK dhe informata të tilla varësisht nga kërkesa e AKK-së;

Akterët Relevant

Për të ushtruar funksionet dhe përgjegjësitë e veta, AKK-ja krijon dhe mirëmban raporte bashkëpunuese dhe procese konsultative me të gjithë akterët relevant të KKK, përfshirë:

- Nxënësin/kandidatin
- Mësimdhënësit dhe trajnerët
- Menaxherët në shkolla, kolegje universitare dhe universitete
- Koordinatorët për sigurimin e cilësisë tek ofruesit
- Punëdhënësit dhe punëtorët
- Ofruesit publik dhe privat të aftësimit profesional
- Sindikata dhe shoqata profesionale
- Qeverinë në nivel qendror dhe lokal
- Agjenci dhe Këshille në nivel kombëtar

Konteksti ynë

Sistemi i Arsimit dhe Aftësimit Profesional (AAP), si dhe ai i Arsimit të Lartë(AL) në Kosovë, duhet t'i plotësojë në mënyrë adekuate nevojat e ekonomisë së tregut. Ngritja e cilësisë së sistemit të Arsimit dhe Aftësimit Profesional dhe Arsimit të Lartë, është prioritet i Qeverisë së Kosovës, në mënyrë që shkathtësitë profesionale dhe kompetencat e individëve që përfundojnë AAP-në dhe AL-në të jenë në nivel të kënaqshëm. Për momentin, ende mbetet sfidë për Kosovën të krijojë një fuqi punëtore të aftë, fleksibile që të mund të konkurrojë në tregun vendor, rajonal dhe global.

Prandaj, një ndër kriteret kryesore që duhet të plotësojnë kualifikimet për tu aprovuar dhe vendosur në KKK është përputhja e këtyre kualifikimeve me kërkesat e tregut të punës. Në këtë mënyrë, ky është ndikimi i drejtpërdrejt i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve në ekonominë kosovare. Kjo kornizë me kriteret e saj parasheh që fillimisht institucionet, të cilat dëshirojnë të zhvillojnë një kualifikim, duhet të paraqesin dëshmi se kualifikimi është i kërkuar në tregun e punës.
Si dëshmi mund të përdoren hulumtimet e tregut të punës, konsultimet, rekomandimet e institucioneve qeveritare që zhvillojnë politika zhvillimore si MASHT, KAAP, OEK, MPMS, etj. Gjithashtu, sipas KKK-së kualifikimet e zhvilluara duhet të bazohen në standarde profesionale, të cilat janë bazë për ta arritur këtë (kualifikimin). Këto standarde profesionale duhet të zhvillohen drejtpërdrejt bazuar në kërkesat e profesionit të caktuar në vendin e punës. Pra, punëdhënësi merr pjesë aktive ne ketë proces dhe paraqet kërkesat e nevojshme, të cilat punëtori duhet t'i demonstrojë për kualifikim në fjalë. Kjo është një ndër kriteret e KKK që duhet të plotësohet nga institucionet, të cilat zhvillojnë kualifikime.

AKK-ja ka zhvilluar dhe hartuar udhëzues të shumtë, të cilët do t'i ndihmojnë që institucionet e arsimit dhe aftësimit profesionale të përmbushin këto kritere dhe të jenë pjesë e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve.




Pamje nga mbledhja e Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve

Si planifikojmë ne

AKK-ja zhvillon politikat dhe strategjitë për krijimin dhe zbatimin e Sistemit Kombëtar të Kualifikimeve në pajtueshmëri me Ligjin për Kualifikimet Kombëtare (Nr.03/L-060). Bazuar në objektivat strategjik të AKK-së, në zhvillojmë Planin e Punës së AKK-së duke përcaktuar prioritet dhe aktivitet për 12 muajt e ardhshëm. Stafi ekzekutiv i AKK-së është përgjegjës për zbatimin e zotimeve dhe aktiviteteve të përcaktuara në Planin e Punës, ndërsa në çdo takim të KD të AKK-së rishikohet progresi i aktiviteteve sipas Planit të Punës.

AKK-ja paraqet raportin mbi progresin e aktiviteteve të veta tek MASHT-i, Zyra e Kryeministrit dhe ministritë relevante të AKK-së, çdo gjashtë muaj, ndërsa raportin vjetor e parashtron në Qeverinë e Kosovës.

Gjatë vitit 2012 janë mbajtur 6 takime të Këshillit Drejtues të AKK-së. Takimet u ndoqën nga anëtarët, përfshirë edhe kryetarin e Këshillit Drejtues z. Gjoshi, si dhe drejtoreshën e AKK-së znj.Danuza.



Pamje nga mbledhja e Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve



Pamje nga mbledhja e Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve

Plani i Punës për vitin 2013

KD i AKK-së në fillim të vitit miratoi Planin e Punës për vitin 2013. Synimet kryesore të AKK-së për vitin 2013 janë si më poshtë:

1. Popullimi e KKK-së me aprovimin e kualifikimeve pas procesit të validimit;

2. Akreditimi i ofrueseve publik dhe privat të arsimit dhe aftësimit profesional në gjithë vendin;

3. Kontributi në sigurimin e cilësisë së programeve dhe aktiviteteve në shkollat profesionale të MASHT-it;

4. Strategjia ndërvepruese e komunikimit, që siguron efikasitet më të madh në procesin e validimit, akreditimit dhe sigurimit të cilësisë;

5. Konsultimi i gjerë me akterët relevantë të KKK-së;

6. Promovimi i KKK-së me organizimin e aktiviteteve që krijon vetëdijesim të audiencës së përgjithshme dhe të synuar për fushëveprimin e AKK-së;

7. Pjesëmarrje të gjerë në projektet e BE-së dhe aktiviteteve ndërkombëtare, si pjesë e zhvillimit të vazhdueshëm profesional të AKK-së.

Plani i Punës për vitin 2013 i detajizuar mund të shkarkohet nga ueb faqja e AKK-së

www.akk-ks.net

RAPORT VJETOR PËR 2013-TËN

Ky raport është një përmbledhje e të gjitha aktiviteteve dhe objektivave të realizuara të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK) gjatë vitit 2013 në përputhje me Planin e veprimit për këtë vit në përputhje dhe në harmoni me Ligjin për Kualifikimet Kombëtare, si dhe sipas Planit Vjetor të aktiviteteve, të hartuar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve dhe miratuar nga Këshilli Drejtues i AKK-së. Në këtë raport do të paraqiten, të ndarë në sektorë, të gjitha aktivitetet e realizuara për zhvillimin dhe implementimin e KKK-së, gjatë këtij viti.

AKTIVITETET E REALIZUARA





Pamje nga Trajnimet për ekspertë për procesin e verifikimit të standardeve të profesionit

Standardet e profesionit

AKK-ja gjatë këtij viti ka trajnuar 11 ekipe për zhvillim të standardeve të profesionit, përgatitjes së dokumentacionit përkatës për zhvillimin dhe verifikimin e standardeve të profesionit dhe verifikimit të 11 standardeve të profesionit.
Standardet e profileve të shëndetësisë janë zhvilluar me mbështetje të Projektit "LuxDevelopment", ndërsa ato për profilin zjarrfikës nga Oda Ekonomike e Kosovës.
Standardet, të cilat janë përcjellë nga KAAP-ja për verifikim dhe validim në AKK, ku si rrjedhojë janë verifikuar këto standarde:

-Shëndetësi
- •Teknik dentar
- •Audiometrist
- •Asistent i farmacisë
- •Asistent i kujdesit social shëndetësor
- •Asistent i ortopedisë
- •Teknik i ortoprotetikës
- •Asistent i sigurisë ushqimore dhe dietave
- •Teknik i optikës

-Sektori i veterinarisë
- •Teknik i veterinarisë,

-Sektori i blegtorisë
- •Teknik i blegtorisë

-Sektori i emergjencave
- •Zjarrfikës

Rregullimi i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve

KKK-ja është e rregulluar përmes mekanizmave që synojnë të sigurojnë përputhje me aranzhimet dhe kërkesat e përcaktuara për sistemin e kualifikimeve, dhe për të siguruar se sistemi ofron kualifikime me cilësi të pranueshme. Tashmë janë rregulluar të gjithë mekanizmat për arritjen e këtyre objektivave:

- Validimi dhe aprovimi i kualifikimeve të propozuara për përfshirje në KKK;
- Akreditimi i institucioneve përgjegjëse për vlerësimin dhe certifikimin e kualifikimeve të miratuara të KKK-së;
- Sigurimi i cilësisë së institucioneve të akredituara dhe ofrimi i kualifikimeve të validuara;
- Sistemi i kredive;
- Njohja e mësimit paraprak.



Korniza Kombëtare e Kualifikimeve

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve për të planifikuar, organizuar dhe zbatuar sa më mirë rregullimin e KKK-së ka mbajtur mbi 50 takime në zyrat e veta që kryesisht kishin të bëjnë me:

- Rishikimin dhe adoptimin e planit të punës,
- Përgatitjen për procesin e validimit dhe akreditimit,
- Përgatitjen e certifikatave dhe vendimeve për akreditim,
- Hartimin e konkurseve për panele të ekspertëve të jashtëm dhe botimit të tyre në gazetat ditore,
- Përgatitjen e listës së ngushtë, intervistimin dhe përzgjedhjen e ekspertëve të jashtëm,
- Përgatitjen e planeve për aktivitetet e SC-së të mbështetura nga Këshilli Britanik,
- Organizimin e konferencave për shtyp,
- Planifikimin dhe organizimin e punëtorive për sigurim të cilësisë,
- Mbështetjen për takimet e Këshillit Drejtues të AAK-së,
- Mbajtjen e takimeve të rregullta me zyrtarët e MASHT-it,
- Organizimin e vizitave në teren dhe për panelet e ekspertëve të jashtëm për validim dhe akreditimin,
- Etj

Në kuadër të rregullimit të AKK-së dhe zbatimit të mekanizmave të KKK-së, AKK-ja ka organizuar punëtorinë për rishikimin e UA 01/2011 mbi kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve. Qëllimi i kësaj punëtorie ishte rishikimi i çdo neni të këtij udhëzimi duke u bazuar në nevojat dhe kërkesat e dala nga terreni me rastin e zbatimit të tij që nga viti 2011 kur edhe është aprovuar ai. Në të njejtën punëtori është hartuar edhe Draft-Rregullorja për verifikimin e Standardeve të Profesionit, e cila përmban kërkesat dhe procedurat për procesin e verifikimit të standardeve të profesionit në nivel shtetëror.
Gjithashtu, gjatë vitit 2013 për të përmbushur një nga objektivat kyçe të dala nga Ligji për kualifikimet kombëtare Nr. 03/L-060 , siç është përmirësimi i njohjes së kualifikimeve në të gjitha nivelet e arsimit dhe aftësimit formal dhe joformal, si dhe të përmirësimi i qasjes në

vlerësim dhe njohjen e mësimit paraprak, është hartuar Draft-Udhëzimi Administrativ për Njohjen e Mësimit Paraprak. Ky Udhëzimin përmban kriteret dhe procedurat që ofruesit/institucionet duhet t'i përmbushin në mënyrë që të implementojnë procesin e njohjes së mësimit paraprak.

Për funksionimin sa më efikas të AKK-së është organizuar punëtoria për hartimin e rregullores së brendshme të AKK-së, ku është bërë harmonizimi me ligjet dhe rregulloret në fuqi për funksionimin e AKK-së, ndarja e sektorëve sipas gjendjes momentale, detyrimet dhe përgjegjësitë e pozitave me radhë, hartimi i një Rregulloreje të brendshme edhe për vitet e ardhshme me rritje të stafit, parashikimi i pozitave për vitet e ardhshme, parashikimi i detyrimeve dhe përgjegjësve për pozitat e mundshme për vitet e ardhshme etj.
Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, për të komunikuar në mënyrë efikase synimet e organizatës, si dhe veprimet e nevojshme për të arritur këto synime, ka zhvilluar Planin Strategjik Afatmesëm të AKK-së. Ky plan ka për qëllim që të koordinojë në mënyrë sistematike burimet dhe veprimet e nevojshme me misionin dhe vizionin e AKK-së.
Gjatë vitit 2013, AKK-ja ka organizuar tre (3) runde të procesit të validimit, kualifikimeve dhe akreditimit të institucioneve ofruese dhe vlerësuese për kualifikime të zhvilluara sipas standardeve të verifikuara kombëtare, apo ndërkombëtare.

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, këtë vit ka bërë regjistrimin e kualifikimeve të validuara në KKK-së për profilet asistent administrativ, saldues dhe TIK , përmes një punëtorie, ku për qëllim kishte rishikimin e kualifikimeve të aprovuara, konkretisht rishikimin e njohurive, shkathtësive dhe kompetencave për nivelet 3 dhe 4 për kualifikimin asistent administrativ dhe saldues, ndërsa për kualifikimin - Teknologji Informative dhe Komunikimit për nivelet 2,3 dhe 4 të KKK-së.

Në këtë punëtori ishin të ftuar zhvilluesit e kualifikimeve dhe ofruesit e akredituar që ofrojnë këto kualifikime të aprovuara në KKK.

Validimii kualifikimeve në KKK dhe akreditimi i ofruesve të AAP

"Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, ka planifikuar, organizuar dhe ka marrë pjesë në të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me validimin dhe akreditimin e ofruesve të AAP-së, përfshirë edhe vizitat e paneleve të ekspertëve në teren. Për këtë proces janë angazhuar edhe ekspertë të jashtëm të fushave përkatëse."

Në fillim të procesit për secilin raund është mbajtur një takim me të gjithë ekspertët e paneleve. Këto takime kishin karakter informues në lidhje me procesin e validimit dhe akreditimit të institucioneve aplikuese.

Procedurat dhe vijueshmëria e punës lidhur me të gjitha grupet e panelit ishte si në vijim:

- Takimi për shqyrtimin e aplikacioneve;
- Vizita në teren;
- Përpilimi i raportit final të vlerësimit për validim të kualifikimit dhe akreditim të ofruesve
- Takim për shqyrtimin e aplikacioneve

Pas takimit të parë informues rreth procedurave të validimit dhe akreditimit, zakonisht janë mbajtur edhe takimet e paneleve për shqyrtimin e materialeve dhe dokumenteve të institucioneve aplikuese.

Vizita në teren

Gjatë vizitave në teren panelet u pritën nga menaxherët e institucioneve, zyrtarët për sigurim të cilësisë dhe mësimdhënësit/trajnerët e profileve përkatëse, nxënësit ose pjesëmarrësit e trajnimeve, ndërsa janë vizituar disa punëtori dhe institucione, në të cilat këta kandidatë janë duke e kryer pjesën praktike.

Fillimisht gjatë vizitës u zbatua verifikimi i gjendjes, dëshmive dhe materialeve sipas aplikacionit për validim të kualifikimeve. Sipas procedurave për validimin e kualifikimit u verifikuan këto pika:

- Modulet
- Struktura e kualifikimit
- Numri i kredive
- Qëllimi dhe përmbajta e kualifikimit/modulit
- Niveli i kualifikimit/modulit në KKK
- Pjesa teorike dhe praktike
- Standardet profesionale
- Njohja e mësimit paraprak
- Mënyra dhe kriteret e vlerësimit
- Literatura

Poashtu gjatë vizitës edhe sipas aplikacionit për akreditimin e ofruesve, u bë verifikimi i gjendjes, dëshmive, infrastrukturës dhe materialeve, duke përfshire këto pika:

- Pajisjet dhe mjetet për praktikë;
- Kabinetet dhe punëtoritë;
- Gjendjen financiare;
- Stafin dhe menaxhmentin;
- Kriteret dhe politikat për vlerësimin e kandidatëve me nevoja të veçanta;
- Qasjen e barabartë për kandidatë;
- Sigurinë dhe shëndetin;
- Certifikimin;
- Bazën e të dhënave

Gjatë këtij procesi u vlerësua përshtatshmëria e objektit me kualifikimin e ofruar, infrastruktura për kandidatë me nevoja të veçanta, siguria dhe çështje tjera me interes.



Pamje nga vizita në QTZH PTK

Përpilimi i raportit final të vlerësimit për validim dhe akreditim

Në kuadër të këtij procesi, panelet përkatëse përpiluan draft-raportet për validimin dhe akreditimin për kualifikimet përkatëse të institucioneve aplikuese. Raportet u krijuan duke u bazuar ne dokumentet, materialet dhe dëshmitë e ofruara, përfshirë edhe vizitat në institucione, si dhe dëshmitë shtesë dhe informatat kthyese nga institucionet përkatëse. Raportet janë pasqyrim i gjendjes së ofruesit dhe vlerësimi i panelit u bazua konform kritereve të Udhëzimit Administrativ të nxjerrë nga Ligji për Kualifikime Kombëtare. Të gjitha draft-raportet janë kthyer në institucione për ta bërë vlerësimin/ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar sipas procedurave të UA.

Pas kësaj procedure raportet finale i janë dërguar Këshillit Drejtues të AKK-së me rekomandime për aprovim apo mos aprovim.
Duhet theksuar se i tërë ky proces gjatë vitit 2013, pa marrë parasysh vështirësitë dhe numrin e kufizuar të stafit që ka AKK-ja, ka rrjedhur jashtëzakonisht mirë dhe në frymën e një bashkëpunimi shumë të ngushtë me institucionet aplikuese dhe palët me interes të përfshira në proces.

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, nga procesi i lartpërmendur ka rezultuar me validimin dhe regjistrimin e këtyre kualifikimeve në KKK:

- Nëpunës i shërbimeve bankare dhe
- Zjarrfikës



Pamje nga vizita në Kolegjin Biznesi



Pamje nga vizita në Institutin për Banka dhe Financa IBF

Gjatë vitit 2013 u rishikuan edhe institucionet e akredituara me kusht, gjatë vitit 2012, si në vijim:

DTC Diakonie
- Instalues i ujësjellësit dhe kanalizimit, niveli i KKK (III)
- Instalues i ngrohjes qendrore, niveli i KKK (III)
- Instalues elektrik, niveli i i KKK (III)

QAP Ferizaj
- Instalues elektrik, niveli i KKK (III)
- Instalues i ujësjellësit dhe kanalizimit, niveli i KKK (III
- Saldues, niveli i KKK (III)
- IT , niveli i KKK (II)

DON BOSKO
- Instalues elektrik, niveli i KKK (III)
- Saldues, niveli i KKK (III)
- Instalues i ngrohjes qendrore, niveli i KKK (III)
- Instalues i ujësjellësit dhe kanalizimit, niveli i KKK (III)
- Asistent administrativ, niveli i KKK (IV)
- TIK, niveli i KKK (II)

Liceu DonBosko
- TIK, niveli i KKK (IV)

QRAP Pejë
- Instalues elektrik, niveli i KKK (III)
- Saldues, niveli i KKK (III)

QRAP Gjakovë
- Asistent administrativ, niveli i KKK (III)
- Saldues, niveli i KKK (III)

QRAP Mitrovicë
- Saldues, niveli i KKK (III)
- TIK, niveli i KKK (II)

Qendra për Zhvillim dhe Trajnim – PTK
- Asistent administrativ, niveli i KKK (III)
- TIK, niveli i KKK (III)

APPK – Prishtinë
- TIK, niveli i KKK (II)

QAKP "Gjon Nikollë Kazazi"
- Asistent administrativ, niveli i KKK (III)
- TIK, niveli i KKK (IV)

QAP Prishtinë
- Instalues i ngrohjes qendrore, niveli i KKK (III)
- Instalues i ujësjellësit dhe kanalizimit, niveli i KKK (III)
- TIK, niveli i KKK (II)

KEK
- Instalues elektrik, niveli i KKK (IV)
- TIK, niveli i KKK (II)

QAP GJILAN
- TIK, niveli i KKK (II)

QAP PRIZREN
- TIK, niveli i KKK (II)



Pamje nga vizita në DTC Diakonie



Pamje nga vizita në QAP Gjon Nikollë Kazazi.



Pamje nga vizita në një institucion të akreditуar nga AKK

Poashtu gjatë vitit 2013 përfundoi me sukses procesi i akreditimit të kurseve të gjuhës angleze, proces ky që kishte filluar në dhjetor të vitit 2012 dhe përfundoi në maj të 2013-tës, me përkrahjen e Mbretërisë së Bashkuar dhe Këshillit Britanik në Kosovë.
Procesi i akreditimit të kurseve ka filluar në shkurt dhe përfundoi në maj të 2013-tes, ku gjithsej janë bërë 22 vizita. Kështu, në vlerësimin e këtyre kurseve kanë qenë të angazhuar gjithsej 7 ekspertë të jashtëm, 3 nga të cilët ishin ekspertë ndërkombëtar dhe 4 vendorë.

Ofruesit e akreditуar nga AKK-ja për të ofruar kurse të gjuhës angleze, janë si në vijim:

- Agjencioni i Përkrahjes së Punësimit në Kosovë "APPK", Prishtinë;
- "Britannica" ELT, Prishtinë;
- "LondonEye", Prizren;
- "New Age School", me një nëndegë, Prishtinë;
- "Oxfrod Studio" me 10 nëndegë brenda Kosovës, 4 degë në Prishtinë, 2 degë në Gjilan, 2 degë në Prizren, 1 degë në Klinë, 1 degë në Istog dhe 1 degë në Gurrakoc;

- Qendra për Zhvillim dhe Trajnim – "PTK", Prishtinë;
- "The CambridgeSchool", Prishtinë;

**lista e emrave të ofruesve është sipas rendit alfabetik*

Ofruesit e kurseve të gjuhëve angleze të akredituar, bartin vulën e cilësisë përmes qëndrueshmërisë institucionale, mësimdhënësve dhe stafit të kualifikuar, si dhe përmbajtjes cilësore të programeve ne përputhje me standardet e Kornizës Evropiane të Gjuhëve te Huaja.



Pamje nga konferenca me gazetarë të organizuar nga AKK dhe Këshilli Britanik për procesin e akreditimit të kurseve të gjuhës angleze, Teuta Danuza drejtoreshë e AKK-së, z. Ragip Gjoshi kryetar i Këshillit Drejtues të AKK-së,
z. Ian Cliff Ambasadorë i Britanisë së Madhe në dhe znj. Arjeta Emra drejtoreshë e Këshillit Britanik në Kosovë.

Promovimi I KKK-së dhe AKK-së

AKK-ja ka zhvilluar dhe zbatuar një strategji të vazhdueshme të komunikimit për të mbajtur të informuar mirë të gjitha palët e interesit, duke përfshirë këtu edhe publikun e gjerë. Kjo është bërë nëpërmjet aktiviteteve dhe mjeteve të ndryshme, si në vijim:

- Mbajtja e takimeve me palët e interesit (ofruesve publik, ata privat dhe të gjithë ofruesve tjerë të AAP-së) në baza të rregullta kohore;
- Organizimi i konferencave, punëtorive informuese për KKK-së / seminare për grupe të ndryshme të caktuara brenda sektorit publik dhe atij privat;
- Organizimin e ceremonisë për shpërndarjen e certifikatave për institucionet ofruese nga procesi i validimit dhe akreditimit;
- Pjesëmarrje në konferenca lokale, regjionale dhe vizita studimore;
- Pjesëmarrja në media elektronike dhe të shkruara;
- Botimi i materialeve promovuese për audiencën e përgjithshme dhe audiencë të synuar;
- Zhvillimi dhe rishikimi i ueb-faqes;
- Publikimi dhe shpërndarja e publikimeve të ndryshme, etj.




KUALIFIKIMET DHE TRAJNIMET
SHKOLLAT PROFESIONALE
TË AKREDITUARA
QENDRAT TRAJNUESE
DIPLOMË
KANË CILËSI
Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority


STANDARDE GJATË ZHVILLIMIT TË MODULEVE MËSIMORE
UDHËZUES PRAKTIK "PAKO E VEÇLAVË"


SIGURIMI I CILËSISË NË INSTITUCIONET E AAP
UDHËZUES PRAKTIK PËR IMPLEMENTIM
UDHËZUES PËR ZHVILLIMIN E MËTUTJESHËM TË SISTEMIT TË CILËSISË PËR VLERËSIM TË JASHTËM TË AAP NË KOSOVË
UDHËZUES PËR SIGURIMIN E CILËSISË TË INSTITUCIONEVE TË AKREDITUARA PËR TË OFRUAR AAP POST-SEKONDATE

Organizimi i konferencave, punëtorive informuese për KKK / seminare për grupe të ndryshme të caktuara brenda sektorit publik / privat

Gjatë vitit 2013 u mbajtën një mori konferencash, punëtori informuese për KKK-në / seminare për grupe të ndryshme të caktuara brenda sektorit publik dhe privat.


Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK) gjatë vitit 2013 ka organizuar gjithsej njëzet e një (21) seminare për sigurim të cilësisë në rajonin e Prishtinës, Ferizajt, Gjilanit , Gjakovës , Mitrovicës , Pejës dhe Istogut. Në këto punëtori kanë marrë pjesë zyrtarët e MASHT-it për AAP-në, koordinatorët për sigurim të cilësisë dhe inspektorët rajonal në secilin regjion. Çështjet e diskutuara në këto punëtori kishin të bëjnë me raportet e vetëvlerësimit të ofruesve të AAP-së për regjionet përkatëse, gjendjen e përshkruar në këto raporte, planet e tyre të përmirësimit, planet zhvillimore, si dhe janë dhënë këshilla dhe sugjerime për të gjitha palët me interes në AAP, në regjionet përkatëse, që do të ndikojnë në ngritjen e cilësisë në sistemin e AAP-së. Këshilli Britanik ka përkrahur organizimin e pesë (5) punëtorive regjionale për sigurim të cilësisë në Ferizaj, Gjilan, Prizren, Prishtinë, Pejë, gjatë periudhës Shkurt, Mars 2013. Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK), poashtu ka organizuar seminar për sigurim të cilësisë për kurset e akredituara të gjuhës angleze. Çështjet e diskutuara në këtë seminar kishin të bëjnë me raportet e vetëvlerësimit, në veçanti me të kuptuarit e principeve të cilësisë nga Korniza Kombëtare e Sigurimit të Cilësisë, përparësitë, progresi i arritur dhe nevojat për ndryshim, etj.



Pamje nga takimet në shkolla të AAP-së e organizuar nga AKK për Kornizën Kombëtare për Sigurim të Cilësisë dhe Raportin e Vet-vlerësimin e mbështetur nga ETF.



Pamje nga seminaret e organizuar nga AKK për Kornizën Kombëtare për Sigurim të Cilësisë.



Pamje nga puna e pjesëmarrësve në seminaret e organizuar nga AKK për Kornizën Kombëtare për Sigurim të Cilësisë.

Një ndër sukseset e arritura gjatë vitit 2013 është edhe organizimi i seminarit "Rishikimi dhe zbatimi i Sistemit Evropian të Kredive i Arsimit dhe Aftësimit Profesional në Sistemin e AAP-së në Kosovë", i mbështetur nga "DVV International". Ky seminar udhëhiqej nga ekspertë të ekipit të Rrjetit Evropian për Sistem të Kredive në AAP-SEKAAP, dhe ai ka siguruar informacione lidhur me procedurat dhe proceset për implementimin e kritereve të SEKAAP-së bazuar në rekomandimet e dala nga Komisioni Evropian (KE)dhe Parlamenti Evropian. Rrjeti Evropian për Sistem të Kredive në AAP - SEKAAP përbëhet nga përfaqësuesit shtetëror të shteteve anëtare të BE-së, partnerët social evropianë dhe ofruesit e AAP-së. Ai ka për qëllim të mbështet të gjitha palët e interesit në implementimin e rekomandimeve te dala nga Komisioni Evropian (KE) për Sistem të Kredive në AAP. Pra, rrjeti është mekanizëm i dalë nga KE-ja dhe mbështet palët e interesit të AAP-së, në shtetet anëtare të BE-së. Një seminar i tillë është mbajtur për herë të parë në vendet e Ballkanit Perëndimor, pasi që seminaret e tilla mbahen vetëm në kuadër të shteteve evropiane. Pra, në rastin e Kosovës është bërë një përjashtim, me qëllim të avancimit të saj në hap me vendet tjera për sa i përket zbatimit të Sistemit Evropian të Kredive.



Pamje nga konferenca "Rrjeti Evropian për Sistem të Kredive në AAP – SEKAAP"



Pamje nga konferenca "Rrjeti Evropian për Sistem të Kredive në AAP – SEKAAP"

Një ndër objektivat e AKK-së për vitin 2013, ishte edhe lidhja zyrtare e KKK-së me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve, me qëllim që të mundësojë mobilitetin e fuqisë punëtore në vendet e Bashkimit Evropian, si dhe barasvlerësimin e kualifikimeve të lëshuara në Kosovë dhe në vendet e Bashkimit Evropian. Për realizimin e këtij synimi,u mbajtën tri (3)punëtoritë për përpilimin e Raportit të Referencimit të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve në Kornizën Evropiane të Kualifikimeve, në sektorin e arsimit për të rritur dhe profesional, sektorin e arsimit të përgjithshëm dhe sektorin e arsimit të lartë. Qëllimi i këtyre punëtorive ishte reflektimi mbi: përgjegjësinë dhe kompetencat ligjore të të gjitha institucioneve kombëtare të përfshira në procesin e referencimit; lidhjen e qartë në mes të Kornizës së Kualifikimeve dhe përshkimit të niveleve sipas Kornizës Evropiane të Kualifikimeve; sqarimin se Korniza e Kualifikimeve Kombëtare, ose sistemi dhe kualifikimet, janë të bazuara në rezultatet e të nxënit dhe janë të lidhura me validimin e mësimit jo-formal dhe informal, si dhe lidhjen e tyre me sistemin e kredive; procedurat për përfshirjen e kualifikimeve në Kornizën e Kualifikimeve Kombëtare, ose për përshkrimin e vendit/pozitës së kualifikimeve në sistemin e kualifikimeve kombëtare, të cilat janë transparente.
Dhe sqarimi se sistemet kombëtare për sigurimin e cilësisë referohen në sistemin e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve dhe janë konsistente me principet dhe udhëzuesit evropian.



Pamje nga punëtoria për raportin e referencimit të KKK-së në KEK.



Pamje nga punëtoria për raportin e referencimit të KKK-së në KEK.

Në dhjetor të vitit 2013, Oda Ekonomike e Kosovës në bashkëpunim me Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve organizoi për herë të III-të garën kombëtare për përvojën më të mirë në fushën e Arsimit dhe Aftësimit Profesional.
Qëllimi i kësaj gare ishte që në fund të saj të jepet shpërblimi për kompanitë private, të cilat kanë investuar kohë dhe para në ofrimin programeve të posaçme dhe inovative, ose edhe në përkrahjen që e kanë dhënë, për të ngritur kapacitetet e punëtorëve të tyre. Pjesëmarrëse në garë kanë qenë kompanitë, të cilat kanë kontribuar edhe në procesin e bashkëpunimit me shkolla, përkrahjen e shkollave me materiale të ndryshme, apo edhe ata të cilët kanë kontribuar në ofrimin e vendeve të praktikës profesionale. Gjatë kësaj ceremonie janë ndarë çmimet për kompanitë fituese,të kësaj gare.

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, gjatë dhjetorit të vitit 2013, poashtu ka organizuar një trajnim njëditor për stafin e Qendrës së Arsimit Tërëjetësor të Universitetit të Prishtinës, për t'i njoftuar lidhur me procesin, kriteret dhe procedurat që duhet të ndiqen për akreditim, rolin e AKK-së në këtë proces, si dhe për zbatimin e KKK-së. Pjesëmarrës në këtë trajnimin ishin profesorë të Fakulteteve të ndryshme të Universitetit të Prishtinës dhe stafi i qendrës së Arsimit Tërëjetësor të Universitetit të Prishtinës.



Pamje nga punëtoria për Qendrën e Arsimit Tërëjetësor të Universitetit të Prishtinës.

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve,ka zhvilluar një hulumtim "Rreth ndikimit të procesit të validimit dhe akreditimit në institucionet/ofruesit të akreditуar", me qëllim që të nxjerr në pah qëndrimet e stafit dhe kandidateve të shkollave/qendrave pas procesit të validimit të kualifikimeve dhe akreditimit nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve. Qëllimi i këtij hulumtimi, ndër të tjera ka qenë gjetja e ndikimit që ka pasur procesi i akreditimit, në përmirësimin e kushteve tek këto institucione/ofertues, sfidat, qasja fleksibile e tyre në kualifikime, si dhe përparësitë dhe mangësitë e procesit.

Poashtu, me qëllim që të nxjerr në pah qëndrimet e stafit dhe nxënësve të shkollave të MASHT-it pas procesit të trajnimeve rreth sigurimit të cilësisë nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve dhe zbatimit të Kornizës Kombëtare të Sigurimit të Cilësisë në AAP, ndër të tjera raportin e vetëvlerësimit, sfidat, qasjen fleksibile në raport me përgjegjësitë e RVV-së, përparësitë dhe mangësitë, AKK-ja gjatë 2013-tes ka zhvilluar edhe hulumtimin me temën: "Shkollat profesionale dhe qëndrimi i tyre rreth sigurimit të cilësisë, Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve dhe Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve".
Të dhënat e nxjerra nga këto dy hulumtime janë prezantuar para aktrëve relevantë të KKK-së, në një ceremoni të organizuar nga AKK-ja, dhe ato kanë reflektuar shkallën e ndikimit të procesit të validimit dhe akreditimit, si dhe zbatimit të KKKSC në AAP dhe KKK bazuar në:

- Rritjen e sigurimit të cilësisë;
- Rritjen e cilësisë në menaxhimin institucional;

- Vetëdijesimin për Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve dhe mësimit gjatë gjithë jetës;
- Kualifikimet e bazuara në nivele, kredi, rezultate të pritshme dhe në kërkesa të tregut të punës;
- Rritjen e punësimit tek kandidatet që kanë përfunduar kualifikimet e validuara në këto institucione të akredituara dhe përshtatja e tyre me tregun e punës;
- Rritjen në qasje dhe besueshmëri krahas institucioneve tjera dhe opinionit publik;
- Rritjen e numrit të kandidateve për vijim të kualifikimeve të validuara;
- Përmirësim në të ofruarit/nxënien e kualifikimeve;
- Inkurajimin e stafit për ngritje profesionale të vazhdueshme;
- Ndikimin e kritereve të reja në certifikata të zakonshme dhe certifikata plotësuese;

Në kuadër të zbatimit të strategjisë për promovimin e KKK-së, Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve në dhjetor të vitit 2013 ka vazhduar fushatën e saj promovuese në TV-të nacionale dhe lokale, si dhe në mjetet e shtypit ditor dhe atij periodik.



Pamje nga Konferenca përmbyllëse e vitit 2013 e organizuar për shprndarjen e certifikatave për pjesëmarësit në punëtoritë rreth Sigurimit të cilësisë dhe prezantimit të rezultateve të hulumtimit të bërë nga AKK rreth qëndrimeve dhe proceset e akreditimit dhe sigurimit të cilësisë.



Pamje nga Konferenca përmbyllëse e vitit 2013 e organizuar për shprndarjen e certifikatave për pjesëmarësit në punëtoritë rreth Sigurimit të cilësisë dhe prezantimit të rezultateve të hulumtimit të bërë nga AKK rreth qëndrimeve dhe proceset e akreditimit dhe sigurimit të cilësisë.

Botimi i materialeve promovuese për audiencën e përgjithshme dhe audiencë të synuar

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve ka qenë shumë i angazhuar në gjysmën e parë të vitit 2013 në dizajnimin, publikimin dhe shpërndarjen e një sasie të konsiderueshme të dokumenteve të prodhuara nga AKK-ja. Dokumentet kryesore janë publikuar në formë të shtypur, me dizajn dhe shenjë adekuate, në tri gjuhët: shqipe, angleze dhe serbe, dhe u janë shpërndarë institucioneve të ndryshme të AAP-së dhe institucioneve tjera që ofrojnë Trajnime, Arsim dhe Aftësim, si dhe palëve me interes në këtë fushë, përfshirë edhe institucionet partnere jashtë vendit.

Këto publikime janë grupuar si më poshtë:

Fletushka informative për AKK-në dhe KKK-në



Raportet vjetore të 2012-tës në të tri gjuhët





Pamje nga posteri i AKK për Ciklin e Cilësisë.

AKK-ja, po ashtu ka publikuar një fletushkë informative që përmban informata mbi rolin e saj në raport me KKK-ë, kualifikimet e aprovuara në të, ofruesit e AAP-së të akredituar nga AKK-ja, si dhe përfitimet e individit, partnerëve social dhe ofrueseve të AAP-së nga zbatimi I KKK-së. Fletushka është shpërndarë në një numër të madh të ngjarjeve dhe takimeve të ndryshme me palët e interesit.

Pjesëmarrja në media elektronike dhe të shkruara

Për të gjeneruar vetëdijesimin e publikut në përgjithësi, është zhvilluar një fushatë me reklama televizive. Kjo ka përfshirë reklamat në kanale televizive kombëtare. Mesazhi i AKK-së që është promovuar në media elektronike ka për qëllim që të ngritë vetëdijen e njerëzve për përfitimet e kandidatëve nga procesi i zbatimit të KKK-së, duke krijuar mundësi të reja për t'u bërë të kualifikuar, ose të ketë kualifikime të njohura, për bizneset duke siguruar se kualifikimet janë të dizajnuar për të përmbushur kërkesat e tregut të punës, dhe për ofruesit, si dhe duke mbështetur zhvillimin e një tregu për të mësuarit gjatë gjithë jetës.
Drejtoresha e AKK-së ka marr pjesë në një numër të programeve televizive dhe të radios, në të cilat është diskutuar roli i AKK-së, funksioni dhe objektivat e KKK-së, mekanizmat e zhvilluara nga KKK-ja për zbatimin e saj, si dhe përfitimet e individit nga zbatimi i KKK-së.


Artikuj të ndryshëm mbi aktivitet e AKK-së u publikuan në këto mediume: Koha Ditore, Zëri, InfoPress, Kosova Sot, Exspress, Lajm, Tribuna Shqiptare dhe Epoka e re.

Zhvillimi dhe rishikimi i ueb-faqes

Zhvillimi dhe lansimi i ueb-faqes së AKK-së është bërë në tri gjuhë. Ueb-faqja përmban informata themelore për AKK-në dhe KKK-në, dokumente dhe publikime, të cilat janë aprovuar nga KD i AKK-së.

Ueb-faqja, gjithashtu përmban materialet e publikuara, në mënyrë që të mund t'iu ofrohen të gjitha palëve të interesuara, dokumentet në format elektronik. Gjithashtu, në këtë ueb-faqe është publikuar edhe lista për institucionet e akredituara. Megjithatë, ueb-faqja është përmirësuar për të sistemuar një sasi më të madhe të informatave dhe për të ofruar mundësi më të mirë kërkimi, si dhe ndërlidhje shtesë me ueb-faqet përkatëse. Në Ueb-faqe janë vendosur edhe video dhe audio incizimet që janë përdorur në fushatën e mediave për të siguruar qëndrueshmëri të vazhdueshme të mesazheve të promovuara.

www.akk-ks.net





Pamje nga seminari për Sigurim të Cilësisë të mbajtur në Londër, OFQUAL,OFSTED.

Bashkëpunimi ndërkombëtar

AKK-ja gjatë vitit 2013 ka marrë pjesë në të gjitha konferencat që kanë pasur të bëjnë me Sigurimin e Cilësisë, ku përveç tjerash në këtë vit në revistën e rrjetit Evropian-EVCET, u publikua artikulli për zbatimin e iniciativave Evropiane në sistemin arsimor të AAP-së në Kosovë. Rrjeti Evropian për Sistem të Kredive në AAP ECVET përbëhet nga përfaqësuesit e shteteve anëtare të BE-së, partnerët socialë evropianë dhe ofruesit e AAP-së dhe ka për qëllim të mbështet të gjithë palët e interesit në implementimin e rekomandimeve të dala nga Komisioni Evropian(KE) për Sistem të Kredive në AAP.

AKK-ja, gjithashtu ka marrë pjesë në të gjitha takimet e organizuara nga EQAVET, ERI SEE dhe ECVET.

Në Janar të vitit 2013 AKK-ja me ftesë të EQAVET ka marrë pjesë në Konferencën Evropiane për Sigurimin e Cilësisë në AAP, të mbajtur në Bruksel. Çështjet e diskutuara ishin: përdorimi i projekteve të EQAVET si instrument, EQAVET për promovimin dhe shpërndarjen e kulturës për sigurim të cilësisë në AAP, si dhe dizajnimi, zhvillimi dhe implementimi i sigurimit të cilësisë në nivel vendi, përdorimi dhe vendosja e mjeteve dhe metodologjisë, dizajnim i gjerë i kampanjës dhe komunikim specifik në marrëdhënie me palët me interes.

AKK-ja, po ashtu ka marrë pjesë edhe në seminarin për Sigurim të Cilësisë të mbajtur në Londër, gjatë muajit Shkurt. Çështjet e diskutuara aty ishin: roli i rregullatorit për njohje dhe akreditim në OFQUAL (Institut përgjegjës për mirëmbajtjen e nivelit të standardeve, përmirësimin e sigurisë dhe shpërndarjen e informacionit në lidhje me kualifikimet); pastaj roli dhe rëndësia e organizatave të pavarura në zhvillimin, shpërndarjen dhe dhënien e kualifikimeve profesionale. Mandej, roli dhe përgjegjësit e OFSTED-it, agjenci që inspekton cilësinë e arsimit parauniversitar ne Angli, etj.





Pamje nga Konferenca e përbashkët e pilot projekteve ECVET, ekspertëve ECVET dhe projektit NetECVET

Në Mars të vitit 2013, AKK-ja mori pjesë në ngjarjen "Forumi vjetor i EQAVET" i mbajtur në Dublin të Irlandës dhe e organizuar nga EQAVET – Rrejti evropian për sigurim të cilësisë në AAP, në Evropë. Qëllimi kryesor i forumit ishte diskutimi me gjithë akterët relevant ndërkombëtarë dhe ekspertët e fushës në nivel evropian, instrumentet ekzistuese për të mbështetur nxënësit, sistemet arsimore dhe punëdhënësit p.sh. EQAVET, ECTS, KEK, ECVET, Karta Evropiane e Lëvizshmërisë Europass, ESCO, etj. Në këtë kontekst EQAVET mund të ofrojë një perspektivë unike në promovimin e

përsosmërisë në AAP.
Është përcaktuar një numër i fushave strategjike, ku progresi është i nevojshëm, siç është: përdorimi i punës i bazuar në të mësuarit për të ndihmuar në lehtësimin e tranzicionit nga të mësuarit për të punuar; zhvillimi i aftësive të përparuara profesionale, të përshtatura për nevojat rajonale; mbështetja për nxënësit e AAP-së dhe një force të kualifikuar të punës; përdorimi më i madh i rezultateve të të nxënit; modernizimi i vlerësimit, në mënyrë që ai të mund të përdoret për nxënësit edhe rreth aftësive të fituara jashtë shkollës duke vlerësuar, vërtetuar dhe njohur; koherenca në mes të instrumenteve të ndryshme evropiane për të mbështetur transparencën dhe lëvizshmërinë; përdorimi i Burimeve të Hapura Arsimore për të lejuar individët të mësojnë kudo, në çdo kohë, pas skemave fleksibile.

Në prill të vitit 2013 AKK-ja ishte pjesë e ngjarjes tri-ditore "Seminar i ECVET për mobilitet", e mbajtur në Varshavë të Polonisë dhe e organizuar nga EQAVET – Rrrejti evropian për sigurim të cilësisë në AAP, në Evropë. Rekomandimet e dala nga ky seminar ishin: të identifikohen hapat drejt zbatimit të një lëvizshmërie të njohur në një kontekst të sigurimit të cilësisë; të identifikohen aktorët kryesorë dhe funksioni i tyre në aplikimin e ECVET sistemit; të komunikohet ECVET dhe vlera e saj për lëvizshmëri;



ECVET development

Teuta Danuza, Director National Qualifications Authority Student Centre Prishtine

A third country perspective- how the European initiatives can inspire change

Kosovo is Europe's newest country and has its youngest population. Following the recent war Kosovo faces major economic, social and educational challenges.

government has implemented a sector-wide annual review of the national education system and this has informed the Kosovo Education Strategic Plan for 2011-2016. A key element of the Plan is the National Qualifications Framework (NQF).

The NQF should improve access to work and further learning by ensuring that qualifications are more relevant and that they meet the needs of learners, the economy employers. The framework includes descriptors of knowledge, skills and competences at eight levels which align with the European Qualifications Framework. The framework was developed with EU technical assistance and was formally established in November 2011.

- stimulate lifelong learning;
- increase access to certification;
- provide learning pathways;
- establish a system for the accumulation and transfer of credit;
- increase the quality and relevance of education and training by stimulating the development of qualifications based on internationally comparable standards of knowledge, skills and competences and be supported by rigorous quality assurance procedures;
- improve employability and learning opportunities for individuals by providing a basis for recognition and certification.

The framework is now being implemented and it has proven to be a stimulus for developing new occupational

Pamje nga Artikull i publikuar ne revistën Evropiane ECVET

AKK-ja, në maj të 2013-tes, me ftesë të ETF ka marrë pjesë në konferencën mbi Procesin e Torinos, të mbajtur në Torino të Italisë. Qëllimi I kësaj konference ishte që të diskutohen dhe shpërndahen të dhënat për te gjitha të arriturat në vendet e Ballkanit Perëndimor, si dhe vendet tjera, me rastin e implementimit të Procesit të Torinos, që nga viti 2010, kur edhe filloi raundi i parë i procesit të Torinos, mbështetur nga ETF. Procesi i Torinos është një përmbledhje e pjesëmarrësve të progresit në arsimin dhe aftësimin profesional (AAP). Politikat hartohen çdo dy vjet nga të gjitha vendet partnere të ETF me mbështetjen e ETF. Korniza analitike liston fushat tematike për shqyrtim, dhe për secilin prej tyre ngre pyetjet kryesore të politikës që do të dokumentohen, në mënyrë që të vlerësojë sistemin e AAP-së dhe përparimin e politikave. Kjo përfshin dimensione të ndryshme të AAP-së (p.sh. mbështetje të vizionit dhe prioritetet politike, efikasitet të jashtëm, efikasitetit të brendshëm, qeverisjen dhe financimin). Bazuar në rezultatet e dala nga kjo kornizë për periudhën dy vjeçare, shtetet implementuese kanë prezantuar dhe diskutuar të arriturat në dimensionet e ndryshme të AAP-së. Nga vendet e BP-së, Kosova dhe Maqedonia ishin të vetmet, të cilat nuk ishin të përfshira në agjendë për të prezantuar.

Në Qershor të 2013-tes, AKK-ja me ftesën e DVV International ka marrë pjesë në takimin e Këshillit Drejtues të Akademisë Rajonale të Andragogjisë, i mbajtur në Podgoricë. Në këtë takim të pranishmit janë njoftuar me planifikimin e aktiviteteve të ARA për vit 2014, kurikula: Global AdultEducation&Learning, temat, të cilat do të përfshihen në diskutim në takimet e radhës dhe ndarja e përvojave rajonale në implementim.

Gjithashtu, AKK-ja në qershor të vitit 2013, me ftesë DVV Internacional mori pjesë në vizitën studimore, në Zagreb. Rekomandimet e dala nga kjo vizitë ishin: përgatitja e vlerësimeve për testim së bashku me elemente thelbësore dhe me procese për promovimin dhe shpërndarjen e kulturës për vlerësim andragogjik me detyra dhe ushtrime, si dhe dallimet në mes të vlerësimeve; prodhimi i instrumenteve matëse, të caktuara si detyrë në grupe, ku si qëllim kishin sistemet dhe mekanizmat e

ndryshëm për vlerësim, si dhe vlerësimi i programeve të arsimit nëpër trajnime. AKK-ja me ftesë të Projektit "Tempus", përmes WUS Kosova mori pjesë në vizitën studimore tre-ditore, në Bukuresht/Rumani, gjatë muajit Qershor. Pikat, të cilat u diskutuan në këtë vizitë ishin: roli i AKK-sënë zhvillimin e kualifikimeve të arsimit të lartë, rëndësia e konsultimit me tregun e punës dhe marrja parasysh e kërkesave të tregut të punës, rëndësia e hartimit të kualifikimeve të arsimit të lartë në rezultatet mësimore, roli i kolegjeve dhe institucioneve të arsimit të lartë në hartimin e kualifikimeve të bazuara në rezultatet mësimore, përparësia e kualifikimeve duke u bazuar në rezultate mësimore të matshme, efektshmëria dhe rezultatet mësimore në njohjen e kualifikimeve dhe përshtatja me kërkesat e tregut të punës duke nxjerre individë kompetent dhe të kualifikuar, etj.

AKK-ja gjatë muajit Qershor ishte pjesëmarrëse në seminarin "Seminari ndërkombëtar për sigurimin e cilësisë në AL dhe AAP në kontekstin e Kornizave Kombëtare të Kualifikimeve", në Kroaci. Seminari kishte për qëllim lehtësimin e dialogut në mes të Arsimit të Lartë (AL) dhe Arsimit dhe Aftësimit Profesional (AAP), veçanërisht duke forcuar çështjen e shkëmbimit të ndërsjellë rreth ndryshimeve dhe ngjashmërive në mes sigurimeve të cilësisë për këto dy sisteme të ndryshme, si dhe për të promovuar kompatibilitet në mes tyre në kuadër të Kornizave Kombëtare të Kualifikimeve. Objektivat specifike të konferencës ishin shkëmbimi i përvojave dhe praktikave të mira nga BE-ja dhe Ballkanit Perëndimor, diskutimi i sfidave, si dhe nxjerrja e një sërë rekomandimesh për implementimin e SC në AL dhe AAP, në vendet e Ballkanit Perëndimor. Në kuadër të kësaj konference u mbajt edhe takimi: Për vendet anëtare të rrjetit të Ballkanit Perëndimor ERI SEE : Zhvillimi i Kornizave të Kualifikimeve Kombëtare.

AKK-ja, në korrik të vitit 2013 ishte pjesëmarrëse në vizitën studimore në Slloveni, ku si objektivë kishte informimin me rolin, fushëveprimin e punës dhe përgjegjësisë së Agjencisë për Arsim Profesional dhe Trajnim dhe Edukim të Rritur (CPI), në Slloveni.
Me theks të veçantë mbi rolin, qëllimin e punës dhe përgjegjësitë e CPI; njohjen me bazën ligjore për themelimin e CPI

dhe rolit të saj, fushëveprimi i punës dhe përgjegjësive në lidhje me ofrimin AAP-së në Republikën e Sllovenisë; kuptimi më i mirë i strukturës së brendshme-CPI së, menaxhimi i proceseve dhe ndarja e detyrave; si dhe fitimi i njohurive praktike dhe marrja e informacioneve të nevojshme për krijimin e Agjencisë AAPAR, në Republikën e Kosovës.

AKK-ja, gjatë muajit tetor mori pjesë si anëtare e Këshillit Drejtues të Akademisë Rajonale të Andragogjisë - ARA në takimin e Këshillit Drejtues të mbajtur në Zvicër, mundësuar nga DVV Internacional me përfaqësi në Prishtinë. Në këtë takim u diskutuan: zhvillimet e trajnimeve të Swiss Federation for Adult Learning - SVEB për trajnerë, funksionimi i SVEB, SVEB certifikata, planifikimi i ARA-së, aktivitetet për fundin e vitit 2013, si dhe planifikimet e mëtutjeshme dhe implementimi i trajnimeve të SVEB për rajonin. Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, në tetor të 2013-tës, me ndihmë të Projektit "Tempus" përmes WUS Austria, mori pjesë në vizitën studimore tre-ditore në Salzburg/Austri. Pikat e realizuara në këtë takim ishin: rëndësia e konsultimit me tregun e punës dhe marrja parasysh e kërkesave të tregut të punës, rëndësia e hartimit të kualifikimeve të arsimit të lartë në rezultate mësimore, roli i kolegjeve dhe institucioneve të arsimit të lartë në hartimin e kualifikimeve të bazuara në rezultatet mësimore, përparësia e kualifikimeve duke u bazuar në rezultate mësimore të matshme, efektshmëria e rezultateve mësimore në njohjen e kualifikimeve dhe përshtatja me kërkesat e tregut të punës duke nxjerrë individë kompetent dhe të kualifikuar, etj.

AKK-ja, në tetor të 2013-tës ka marrë pjesë në konferencën e përbashkët të pilot projekteve ECVET, ekspertëve të ECVET dhe projektit NetECVET. Në këtë takim të pranishmit janë njoftuar me ndikimin e ECVET, NetECVET – rrjeti i Sistemit Evropian të Kredive të AAP-së, nevojat dhe praktikat për implementim, lëvizshmëria, politikat e BE për ECVET, mësimi gjatë gjithë jetës, njohja e mësimit paraprak – ECVET, si dhe barrierat në realizmin e këtij procesi.

Vizitë zyrtare e AKK-së në Bruksel – Belgjikë, në muajin nëntor 2013 me ftesë të EQAVET. Konkluzionet e dala nga ky takim ishin: praktikat më të mira për

sigurimin e cilësisë në AAP, rritja e sinergjisë në mes të EQAVET, njohja reciproke e diplomave në mes të vendeve anëtare, rëndësia që politikat të jenë të bazuara në dëshmi, mbajtja e komunikimit të vazhdueshëm nga shfrytëzuesit e EQAVET për shkëmbimin e përvojave dhe implementimin e EQAVET, thjeshtësimi apo harmonizimi i këtyre mekanizmave EQAVET dhe ECVET. Gjatë kësaj punëtorie u paraqiten disa modele të praktikave nga disa ekspert të ndryshëm të EQAVET në lidhje me implementimin e sigurimit të cilësisë, ndërsa si shembull i praktikës së mirë në këtë fushë u përmenden disa shtete për praktikat e implementimit të EQAVET si, Rumania, Gjermania, Mbretëria e Bashkuar, Holanda etj. Këto përvoja u mendua se janë të arritshme dhe të aplikueshme edhe në vendin tonë, me qëllim të ngritjes së cilësisë në sistemin e arsimit dhe aftësimit profesional.

Në nëntor të vitit 2013, Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve me ftesë të DVV Internacional ka qenë pjesë e vizitës studimore në Bonn – Gjermani. Në këtë vizitë u diskutuan: roli dhe funksionimi i Institutit Gjerman për Arsim të të Rriturve, promovimi i punës arsimore në komunitetin gjerman për arsimin e të rriturve, sfidat sociale: integrimi në një shoqëri multikulturore, ndryshimi demografik, papunësia, vlerësimi i kompetencave, përdorimi i Profil PASS, programet për kualifikim të mësimdhënësve, pjesëmarrja në trajnime relevante për vendin e punës për mësimdhënësit dhe stafin pedagogjik e administrativ, vlerësimi i mësimdhënies dhe mësimdhënësit, përgjegjësitë e Odës Ekonomike dhe Industriale, etj.

Poashtu, AKK-ja ka marr pjesë në një seminar, në Hamburg të Gjermanisë me ftesë të ECVET, gjatë muajit nëntor.

Pikat e realizuara në këtë seminar ishin: kuptueshmëria e mobiltetit, sipas ECVET në nivel ndërkombëtar, procesi i implementimi të mobiltetit sipas parimeve të ECVET në bazë të përvojave të disa vendeve të ndryshme, rëndësia e identifikimit apo njohjes së rezultateve të të nxënit si kriter i rëndësishëm i njohjes duke mundësuar mobilitet, rëndësia e moduleve dhe rezultateve të të nxënit sipas ECVET, prezantimi i disa shembujve të mobilitetit nga Italia dhe Gjermania, si dy vende me traditë në këtë drejtim, identifikimi i teknikave specifike gjatë mobilitetit sipas ECVET, Memorandumi i


bashkëpunimit dhe përmbajtja e këtij memorandumi, identifikimi i palëve përgjegjëse për mobiltet, marrëveshjet e mësimit për mobilitet, kuptimi i pikëve të ECVET, përfitimi dhe akumulimi i këtyre pikëve nga kandidatët, përgjegjësitë e palëve nënshkruese, si dhe identifikimi i institucioneve përgjegjëse për njohjen e mobiltetit sipas parimeve të ECVET.
Në dhjetor të vitit 2013, AKK-ja ka marrë pjesë në konferencën me temë:

"Kualifikimi si një rrugë drejt cilësisë",në Vjenë me ftesë të ARQAVET. Çështjet e diskutuara në këtë konferencë ishin: parimet e menaxhimit dhe zbatimi i tyre në praktikë për sigurim të cilësisë; shkolla në rrugën për t'u bërë një organizatë e të mësuarit; reagime të bazuara në dëshmi të informatave kthyese dhe menaxhimit; trajnimi dhe planifikimi në arsimim të vazhdueshëm në shkolla profesionale.






Shënim



AUTORITETI KOMBËTAR I KUALIFIKIMEVE / NACIONALNI AUTORITET ZA KVALIFIKACIJE / NATIONAL QUALIFICATION AUTHORITY / 2014
























Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Adresa:
Qendra e Studentëve
Rr. Agim Ramadani p.n
Prishtina 10000
Republika e Kosovës
Tel: +381 (0)38 212-595
Fax: +381 (0)38 213 433

Për me shume vizitojeni faqen:
www.akk-ks.net